



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 434/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muhammed Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi, duke vendlodur lidhur me ankesën subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Fryma e Re (FER), me seli në Ferizaj, për shkak të mbulimit të posterave, në seancën e panelit të mbajtur me 23.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

MIRATOHET ankesa si e bazuar, e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me nr. A-434 e datës 11.12.2010 kundër subjektit politik Fryma e Re (FER).

FER-it, i shqiptohet dënim i më gjobë në vlerë prej 1550 (njëmijë e pesëqind e pësëdhjetë) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimit të këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Subjekti politik PDK, ka parashtruar ankesë më te cilën pretendon se subjekti politik FER, ka bërë shkelje të nenit 33 pika (b) të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/09 nen 3 paragrafi 1 pika (b), *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët*, në ankesë theksohet se më datë 10.12.2010 në ora 17:30 në rrugën “Dëshmorët e Kombit” në Ferizaj, është vërejtur se subjekti politik FER ka vendlodur posterat e PDK-së, lidhur me fushatën zgjedhore

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 11.12.2010, nga subjekti politik PDK, në të cilën theksohet se subjekti politik FER ka vendlodur posterat mbi ata të PDK-së lidhur me fushatën zgjedhore e që është në kundërshtim me nenin 33 pika (b) të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/09 nen 3 paragrafi 1 pika (b), *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët*.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur pesë fotografji si dëshmi, në të cilat shihet qartë se posteri i subjektit politik FER, është vendlodur mbi atë të PDK-së.

Në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it:

PZAP-i e informoi subjektin politik FER, më datë 11.12.2010, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 12.12.2010, gjerë në ora 12:00. PZAP-i, mori përgjigjeje në ankesë nga subjekti politik FER, sipas afatit të caktuar për të svaruar lidhur me shkeljen e pretenduar ku thuhet se FER konsideron se nuk ka bërë shkelje të dispozitave në fuqi pasi që sipas tyre ata nuk kanë gjetur postera përmbi atyre të PDK-së. Fotoja në fjalë nuk dokumenton që ky subjekt politik ka hequr posterin e PDK-së.

Veprimet e Ndaluara të Subjekteve Politike

Dispozita ligjore e Nenit 33 pika (b) i LZP-së dhe nen 3 paragrafi 1 pika (b) e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009, parashohin se:

Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërrja e ndonjërës si në vijim:

b) vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose hapësirave private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve.

Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parashev se:

Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ose rregullave të KQZ-së, mund të:

c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).

Gjatë përcaktimit të vlerës së gjobës ndaj subjekti politik për ndonjë shkelje, PZAP-i ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktivitetave të lidhura më fushatën zgjedhore.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se posteri i subjektit politik FER janë të vendosur mbi ata të PDK-së në rrugën “Dëmorët e Kombit” në Ferizaj, nga kjo arsy e dhe më qëllim të evitimit të shkeljes së lartë cekur po ashtu në pajtim më dispozitat e

lart cekura ligjore PZAP-i vlerëson se ankesa është e bazuar, e lidhur me nenin 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 434/2010 më datën 23.12.2010

